



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1188
Dt. Rregj. 17.04.2015

Nr. Vendimi 871
Dt. Vendimi 05.11.2015

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 05.11.2015, ora 12.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them1188 datë 17.04.2015 me pale ndergjyqese:

PADITËS: Pjetër Selita, person fizik me TVSH, me nipt K66919001 Ume adresë Velipojë-Plazh, Shkodër, me administrator Pjetër Selita, i biri i Prel, i datëlindjes 28.11.1961, lindur dhe banues në Velipojë, Shkodër.

TE PADITUR: 1-Drejtoria Rajonale e Tatimore Shkodër.
2-Drejtoria e Apelimit Tatimor-pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 32 e vijues i K.Pr. Civile, neni 15, 17, 35 të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative, neni 116, 117 e vijues i K.Pr. Administrative si dhe Ligji Nr9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.Sh-se" i ndryshuar, udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi palën paditëse z. Pjetër Selita, i cili kërkoi përfundimisht pranimin e kerkese padisë sipas objektit të saj, përfaqesuesen e palëve të paditura

znj. Siriana Bakushi, e cila u shpreh për rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj dhe prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se

Paditës Pjetër Selita I është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkoder me kërkesë padi kunder anës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me objekt:

Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë".

Paditesi Pjetër Prel Selita është i regjistruar si subjekt tatimpagues, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me numër Nipti K66919001U, me objekt aktiviteti "hoteleri...".

"Grupi i punës", përbërë nga punonjës të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Sektori i Verifikimit në Terren dhe Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në zbatim të detyrave funksionale, Urdhrit të punës nr.546/3 prot, nr.729/4 prot datë 08-09.07.2014 ka ushtruar një kontroll në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit Pjetër Prel Selita, me Nipt K66919001U, me adresë "Velipojë", në orën 09.15 min.

Grupi i kontrollit tatimor në zbatim të detyrave funksionale ka mbajtur Akt konstatimin me nr.0421766 datë 08.07.2014, në të cilin ka pasqyruar faktet e konstatuara. *Sipas Akt konstatimit datë 08.07.2014 është konstatuar ndër të tjera :Në momentin e kontrollit u gjend në punë Rake Selita.*

Me njoftim-vlerësimin nr.38/31 prot datë 06.01.2015, ana e paditur ka vendosur dënim për punonjës të padeklaruar në vlerën 250.000 lekë dhe gjobë në vlerën 10 000 lekë për mosdorëzim në afat të E-SIG 027/A.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore në lidhje me këtë vlerësim. Kjo drejtori me vendimin nr 2172/1 dt 19.03.2015 ka vendosur :

Lëniën në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi, njoftim vlerësimit nr.38/31 prot dt.06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër *për gjobën e vendosur për mosdorëzim të formularit E sig/027, për shumën 10 000 lekë.*

Ne gjykim paditesi parashtroi se;

Me njoftim vlerësimin tatimore 38/31 Prot date 06.01.20 14,jemi gjobitur , denim me gjobe 10 000 leke per deklarim te vonuar te ESIG27A per periudhen 2014/07 dhe gjobe 250 000 leke per punetor te padeklaruar me sigurime shoqerore e sigurime shendetsore.

Per periudhen ne fjale me daten 03.07.2014 kemi bere kerkese per shtese per nje vend te lire pune ne Zyren e Punes Shkoder .

Me daten 07.07.2014 e kemi regjistruar ne pune znj.Rake Ded Selita (sipas rregullave ligjore ne fuqi).

Me daten 08.07.2014 ka ardhë një kontroll nga Drejtoria e Tatimeve Shkoder ,ku kanë konstatuar dhe gjetur ne pune znj.Rake Selita.duke lene edhe një akt konstatimi.

Inspektori i Tatimeve ka parë edhe kontratën e lidhur me zyrën e punës për zënjën në fjalë dhe nuk ka patur nevojë të mbajë një proces verbal për venie gjëje sepse çdo gjë ishte në rregull.

Sipas rregullave ligjore kemi tentuar ta deklarojmë on-line 24 orë përpara në faqen e tatimeve, pra më 06.07.2014 dhe nuk arritem ta deklarojmë sepse faqja e tatimeve nuk punonte.

Në një datë të mëvonëshme e kam deklaruar on-line në faqen e tatimeve dhe për këtë person për muajin korrik kemi paguar sigurimet shoqërore dhe e kemi paraqitur në listë pagesën e korrikut 2014.

Gjyba është vënë nga inspektori i vlerësimit në zyrë pa e njohur problemin dhe pa verifikuar konstatimin e datës 08.07.2014 kemi ushtruar ankimin dhe apeli tatimore me vendimin nr 2172/1 dt 19.03.2015, ka shfuqizuar pjesërisht njoftim vlerësimit tatimore nr 38/31 dt 06.01.2015 duke hequr gjyben e vendosur për mosdorezim të formularit E sig/07, për Shumën 10.000 lekë dhe ka lënë në fuqi gjyben për mos deklarim pranë organit tatimore të një punonjësi të punësuar, për shumën 250.000 lekë.

Gjybe në shumën 10 000 për deklarim të vonuar bie ndesh totalisht me shprehjen një punonjësi i padeklaruar sepse në datën e kontrollit në vendin e aktivitetit, punonjësi ishte në punë dhe i deklaruar në zyrën e punës.

Sqarohet se aktmarrëveshja me zyrën e punës prej dy vitesh nuk kërkohej të dorëzohet në zyrën e protokollit të tatimeve. Për këtë arsye i kërkojmë gjykatës pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të kërkesë-padië.

Ana e paditur parashtroi se;

Nga organi tatimor është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si "të punësuar" nga subjekti paditës para organit tatimor, detyrim ligjor ky për të, për periudhën tatimore korrik/2014.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se punonjësi i gjendur në punë nuk është deklaruar në organin tatimor konform rregullave dhe afatëve të përcaktuara ligjore.

*Rezulton se subjekti më vonë ka bërë deklarimin e punonjësës për organin tatimor sipas Formularit të deklarimit "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe e të larguarve nga puna formulary E-SIG 027/a", deklaruar para organit tatimor **vetëm me datën 08.09.2014, ku subjekti dhe nëpërmjet këtij formulari ka deklaruar si datë fillimi pune për punonjësen në fjalë datën 07.07.2014**, pra jashtë afatëve të përcaktuara nga ligji dhe pas konstatimit të bërë. (Akt konstatimi është mbajtur me datën 08.07.2014).*

Mbi bazën e kësaj praktike nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër është mbajtur Akt dënimi me nr.2788 prot datë 30.12.2014. Për këtë arsye subjekti është vlerësuar me gjybe në vlerën 250.000 lekë sipas njoftim vlerësimit tatimor për punonjësi të konstatuar të padeklaruar pranë organit tatimor. (bazuar në nenin 1129 I ligjit 9920 /2008 "Për procedurat tatimore në RSH-së" i ndryshuar. Pasqyruar kjo në njoftim vlerësimit tatimore nr 38/31 dt 06.01.2015.

Ky njoftim vlerësim i është njoftuar subjektit në zbatim të procedurave ligjore.

Subjekti ka marrë dijeni për vlerësimin me njoftim vlerësimit tatimor, ai në vijim ka apeluar pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, e cila është shprehur me vendimin e saj.

Në lidhje me pretendimin e subjektit paditës për mosfunksionimin e faqes zyrtare të tatimeve për deklarimin në afat të punonjësës "Rake Selita", ky pretendim është i pabazuar, pasi sistemi ka punuar rregullisht, nga ana tjetër subjekti nuk provon

pretendimin e tij me asnjë lloj komunikimi të mundshëm me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkoder në datën e pretenduar se nuk ka funksionuar sistemi tatimor për deklarim on-line, nuk konfirmon para gjykatës se i është drejtuar këtij organi me pretendimin se nuk funksionon faqja zyrtare për deklarim dhe si duhet të procedojë në lidhje me detyrimin e tij për deklarim. Per pasoje kerkojme rrezimin e kerkese padise.

Gjykata veren se

Referuar Neni 119 i këtij ligjit 9920/2008 ku thuhej;

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

(a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

2. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkëljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit.

Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, pika 119. "Mosdeklarimi i të punësuarve" shpreh :

119.1 Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta.

Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë në subjekt apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve.

Duke ju kthyer rastit në gjykim provohet se tatimpaguesi Prele Selita, me dt 03.07.2014 ka bere kerkese per shtese per nje vend te lire pune ne Zyren e Punes Shkoder .Me daten 07.07.2014 e ka regjistruar ne pune znj.Rake Ded Selita (sipas rregullave ligjore ne fuqi), dhe se sigurimet per kete punonjese i kane filluar qe me dt 07.07.2014 (sipas deklarates E-SIG 027/a", deklaruar para organit tatimor **me datën 08.09.2014**). Kjo vonese ka ardhë për shkakë që nuk varen nga tatimpaguesi, pasi në keto data nuk ka funksionuar sistemi elektronik e deklarimit on-line nga ana e drejtorise Rajonale të Tatimeve Shkoder, dhe se kete pergjegjesi nuk munde ta mbaje tatimpaguesi, por eshte detyrim ligjore i anes se paditur DRT- Shkoder, qe te siguroje 24 ore funksionimin eficient te sistemit .

Pretendimi i anes se paditur qe sistemi ka funksionuar, mbetet vetem ne kuadrin e pretendimit i pa provuar para gjyates, me prove shkesore, pasi ana e paditur nuk ka sjelle ndonje deklarim te po kesaje date, te ndonje subjekti tjeter, me qellim te vetem qe te provonte qe sistemi ka funksionuar.

Nga ana tjeter gjykata krijon bindjen se pretendimi i paditesit eshte i provuar me fakte konkrete pasi eshte paditesi i cili ka ndermarre te gjitha veprimet e punesimit duke plotesuar dhe deklaraten e punesimit nje dite para fillimit te punes, pikerisht me dt

07.07.2014 (kontrolli është ushtruar me dt 08.07.2014), dhe se nuk kishte asnjë pengesë ligjore që ta bente dhe deklarimin on-line, përveç mos funksionimit të sistemit që nuk është përgjegjësi e tatimpaguesit.

Në keto kushte gjykata vlerëson se zbatimi i ligjit duhet të kërkohej të zbatohet nga të tjerët pasi të jenë eficient të gjithë mekanizmat qofshin keto dhe elektronik për krijimin e kushteve të mundshme për të tretet në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit, dhe se ky detyrim ligjor i buron vetëm institucioneve të administratës shtetërore sic dhe në rastin në shqyrtim DRT-Shkoder.

Po kështu është provuar se paditesi ka dërdhur të gjitha kontributet për të punësuar rishtazi tashme të deklaruar në zyrën e punës sipas ligjit në përputhje me Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në RSH-së", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26, datë 16.04.2009, në zbatim të këtij ligji është përcaktuar detyrimi ligjor i çdo tatimpaguesi për të deklaruar në organin tatimor, në afatin e përcaktuar çdo punëmarrës, me anë të formularit E-SIG 027/a "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe të larguarve nga puna" (nëse ka të punësuar për herë të parë, të punësuar rishtazi, ose të larguar nga puna; çdo person juridik e fizik, në biznesin e madh apo biznesin e vogël është i detyruar të deklarojë këtë pasqyrë në organin tatimor të pakten 24 orë përpara fillimit të punës së të punësuarve, që fillojnë punë për herë të parë të subjekti përkatës apo janë të punësuar rishtazi si dhe brenda 10 ditëve për të larguarit nga puna, sa herë që të subjekti ndodhin ndryshime të tilla.

Nga sa mesiper analizoi gjykata e gjene kerkimin e paditesit te mbeshtetur ne prova dhe ligje dhe **vendose pranimin e kerkese padise.**

Konfrom nenit 45 te ligjit 49/2012 ky vendim per shkak te vleres se aktit eshte i formes se prere dhe nuk lejohet ankim, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40,41,45 pika b të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nenit 126 dhe 306 të K.pr. Civile

VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrim tatimor nr.38/31 prot datë 06.01.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi me shkresën nr.2172/1 prot datë 19.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë të dhene ndaj paditesit Pjetër Selita (person fizik).

-Shpenzimet gjyqesore (në vlerën e taksës së padisë 3000 lekë) në ngarkim të palës së paditur.

-Ky vendim është i formës së prerë, perben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të menjëhershme.

-Kunder vendimit nuk lejohet ankim.

-**Shkoder me date 05.11.2015**

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



GJYQTARE

Valbona DURRAJ

